



Prishtinë, 21 nëntor 2008
Kodi ZRRE-së: V_133_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit Nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
2. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_06_2008 “Mbi Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_07_2008 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009”;
4. Raportimin rregullativ dorëzuar nga NQ Gjakova SH.A, Zyrës së Rregullatorit për Energji, që përmban informatat për të ardhurat dhe shpenzimet, për asetet, investimet, informatat teknike dhe për konsumatorë që u realizuan në sezonin e ngrohjes 2007/2008;
5. Aplikimin për tarifa për sezonin e ngrohjes 2008/2009 dorëzuar nga NQ Gjakova SH.A, Zyrës së Rregullatorit për Energji, që përmban informacione lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara, asetet / planin investues, dhe prodhimin e furnizimin e parashikuar të ngrohjes;

Në mbledhjen e mbajtur me datë 21 nëntor 2008, nxori këtë:

VENDIM

1. Aprovohen të Ardhurat e Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Gjakova SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009

Në €		
R	Të Ardhurat e Lejuara	993,561
R _F	Pjesa Fikse e të Ardhurave të Lejuara	140,653
R _V	Pjesa Variable e të Ardhurave të Lejuara	852,908

2. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe;

3. Ky Vendim hyn në fuqi datën e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda 14 ditëve nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Vendimit i bashkëngjitet Raporti Rregullativ: Përcaktimi i të ardhurave të lejuara për NQ"Çjakova" Sh.A. për sezonin e ngrohjes 2008/2009.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar